



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

NJOFTIM

Në mbledhjen e datës 26 shkurt, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe diskutimeve të zhvilluara në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, mori vendimet që vijojnë:

U miratua kërkesa e shoqërisë “PROINFINIT CONSULTING” sh.p.k. për heqjen e licencave në veprimtarinë e furnizimit dhe të tregtimit të energjisë elektrike.

U miratua llogaritja e pagesave rregullatore për vitin 2026.

U vendos shtyrja e vendimmarrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë “VOLTON” sh.p.k. për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me shoqërinë OSSH sh.a., bazuar në kërkesën e “VOLTON” sh.p.k. për mos përfundimin e procedurës të filluar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 345, datë 29.12.2025 në kushtet që ky subjekt bën me dije kërkesën për pezullim për Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë pranë të cilës ka depozituar kërkesë-padi.

Vendimet e plota publikohen në faqen zyrtare të ERE-s dhe në Fletoren Zyrtare.